



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:147427

Datë: 14.12.2020

Numri i dokumentit: 01339713

P.nr.936/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarve B. S, K e Gjilanit dhe E. K nga Gjilani për shkak të veprës penale zjarrevënia nga neni 322 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 35 të KPRK-ës, të cilët sipas autorizimeve i mbrojnë avokatët Ilir Rashiti dhe Jeton Ibrahimimi që të dy nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1850/2020, të datës 17.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 11.12.2020, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 14.12.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

B. S nga babai K. dhe nëna B. e lindur R., i lindur me datë ... në Gjilan ndërsa me vendbanim në, Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 2 fëmijëve, me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, i papunë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

E. K nga babai Sh. dhe nëna S., e lindur K., i lindur me datë... në Gjilan, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Sepse me datë 24.10.2020, i akuzuari B.S me marrëveshje paraprake me të akuzuarin E. K, vie në Gjilan, me ç'rast i akuzuari E. në pikën e karburantit e blen benzinën me një bidon, e më pas ndalet në Gjilan derisa i akuzuari B.S, me veturën e tij të markës , shkon, e më pas rreth orës 21:10 minuta shkon tek shtëpia e të dëmtuarit B. S, e kalon murin, hyn në oborr dhe me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit ia vë flakën automjetit të të dëmtuarit të markës me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë e kaltër ndërsa automjetin e llojit . me tabela të regjistrimit ... e dëmton duke e spërkat me benzinë, e me të kuptuar i akuzuari se është vërejtur nga anëtarët e familjes së të dëmtuarit ik nga oborri duke e kaluar murin, me ç'rast të dëmtuarit B. S i shkaktojnë dëm në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka kanë kryer veprën penale zjarrëvënia nga neni 322 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 35 të KPRK-ës

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 233 e 365 të KPP-ës, të akuzuarit e lartcekur:

I GJYKON

Të akuzuarin B. S me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëtdhjetë) ditëve i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit dhe në kuptim të nenin 44 i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 2500 € (dymijë e pesëqind euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa

Të akuzuarin E. K me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindpesëdhjetë) ditëve i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit dhe në kuptim të nenin 44 i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1200 € (njëmijedyqind euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë, nuk munden ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet secilit prej tyre veç e veç në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet një ditë burgim.

Të dëmtuarit B. S dhe I. S për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës të akuzuarit B.S, koha e kaluar në paraburgim nga data 31.10.2020 deri me datë 11.12.2020 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë ndërsa të akuzuarit E. K koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 31.10.2020 deri me datë 11.12.2020 po ashtu do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Obligohen të akuzuarit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Me datë 17.11.2020, Prokuroria Themelore në Gjiilan, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.1850/2020, kundër të akuzuarve B. S , Komuna e Gjiilanit dhe E. K nga Gjiilani, për shkak të veprës penale zjarrëvënia nga neni 322 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 35 të KPRK-së.

Me datë 11.12.2020, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë janë trajtuar edhe marrëveshjet lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë dhe të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre në anën tjetër po ashtu në këtë seancë kanë prezantuar, prokurorja e shtetit, e dëmtuara Ismete Syla, të akuzuarit B. S dhe E. K me mbrojtësit e tyre avokatët Ilir Rashiti dhe Jeton Ibrahim. Në këtë seancë gjykata me aktvendim ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij në anën tjetër dhe rrjedhimisht palët kanë dhënë edhe fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes se arritur me të akuzuarit e lartcekur ashtu siç është e cekur në piken I, II, III dhe IV dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqiptoj dënimet sikurse janë evidentuar në këto marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. S Av. Ilir Rashiti në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje si dhe ka kërkuar nga ana e gjykatës që një dënim i tillë të aprovohet.

I akuzuari B. S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësin të tij dhe ka shtuar se kërkon falje për veprimet e tija dhe në prezencë të të gjithëve i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe premtion se në të ardhmen nuk do të bëjë vepra të tilla e as vepra të tjera penale dhe se kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. K, Av. Jeton Ibrahim në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje si dhe kërkon nga ana e gjykatës që një dënim i tillë të aprovohet.

I akuzuari E. K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësin të tij dhe ka shtuar se kërkon falje për veprimet e tija po ashtu në prezencë të të gjithëve i kërkon falje të dëmtuarit dhe premtion se në të ardhmen nuk do të bëjë vepra të tilla e as vepra të tjera penale dhe se kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

2.Vlerësimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën janë vlerësuar edhe marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë dhe të akuzuarve me mbrojtësit e tyre në anën tjetër gjykata pas dëgjimit të palëve lidhur me marrëveshjen e mbi pranimin e fajësisë të arritur në bazë të nenit 233 paragrafi 21 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka

pranuar marrëveshjen e lartcekur ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 233 paragrafi 18 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura në mes të prokurorit të shtetit në njërin anë si dhe të akuzuarve me mbrojtësit e tyre në anën tjetër i përmbushin të gjitha kushtet ligjore si dhe të njëjtat janë arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë, siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-1175, i datës 24.10.2020, raporti i shpejtë i datës 24.10.2020, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 24 dhe 25.10.2020, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, raportet e oficerëve, deklarata e të dëmtuarëve B.S dhe I. S, deklaratat e të akuzuarve B. S dhe E. K, CD me video incizim si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu gjykata në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të akuzuarit B. S , Komuna e Gjilanit dhe E. K nga Gjilani kanë kryer veprën penale zjarrvënien nga neni 322 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 35 të KPRK-ës, në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve duhet t'iu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së ndërsa si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit ka marrë faktin se të njëjtit kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, të njëjtit janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla e as vepra të tjera penale po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të njëjtit ka marrë edhe rrethanat personale dhe karakterin e tyre ku nga shkresat e lëndës shihet se për të njëjtit është hera e parë që bien ndesh ligjin dhe më parë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarve për të kryer veprën penale ngase nga shkresat e lëndës si dhe vet përshkrimi faktik del se të akuzuarit pas një marrëveshjeje paraprake veprojnë siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi, po ashtu gjykata si rrethanë rënduese për të akuzuarit mori edhe shkallën e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprës penale ngase nga shkresat e lëndës del se të dëmtuarit B.S i janë dëmtuar dhe automjetet ai i markës dhe ai i markës andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihen edhe qëllimet e dënimit nga neni 38 të KPRK-së, të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe

rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Llogaritja e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimet e shqiptuara.

Duke pasur parasysh se i akuzuari B.S ka qëndruar nën masën e paraburgimit nga data 30.10.2020 deri me datë 11.12.2020 ndërsa i akuzuari E. K ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak po ashtu nga data 30.10.2020 deri me datë 11.12.2020, gjykata në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës, kohën e kaluar nën masat e lartcekurve të akuzuarve ua llogariti në dënimet e shqiptuara me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit B. S dhe I .S i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të akuzuarit veç e veç ti detyrojë ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.936/2020, me datë 14.12.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Meqenëse prokurori i shteti, të akuzuarit si dhe mbrojtësit e tyre në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës atëherë ky aktgjykim në bazë të nenit 485 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, merr formën e prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm sot me datë 14.12.2020.